

# **RREGULLORE PËR REGJISTRIMIN, ANËTARËSIMIN DHE LIÇENSIMIN NË URDHRIN E MJEKËVE**

## **Neni 1. Baza Ligjore**

Kjo Rregullore është hartuar në mbështetje të Ligjit Nr. 123/2014 "Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë", Ligjit 10107 "Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", Ligjit 10171 "Për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Shqipërisë", Statutit të Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë, si dhe të Rregullores "Për Praktikën Profesionale për Profesionistin e Shëndetit në Republikën e Shqipërisë".

## **Neni 2. Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është vendosja e kriterëve dhe normave për regjistrimin, anëtarësimin dhe pajisjen me Liçensën për ushtrimin individual të profesionit të mjekut.

## **Neni 3. Dispozita të Përgjithshme**

1. Urdhri i Mjekëve të Shqipërisë krijon dhe administron Regjistrin Themeltar të anëtarësisë.
2. Proçesi i krijimit dhe administrimit të Regjistrit Themeltar të Mjekëve qëndron në themel të misionit dhe të veprimtarive të Urdhrit.
3. Këshilli Kombëtar dhe ai Rajonal janë strukturat që vendosin për anëtarësimin në Urdhrin e Mjekëve dhe pajisjen me liçensën për ushtrimin individual të profesionit.
4. Aparati Qëndror i Këshillit Kombëtar është autoriteti përgjegjës për krijimin, përditësimin dhe mirëadministrimin e Regjistrit Themeltar.

## **Neni 4. Regjistri Themeltar i Urdhrit të Mjekëve**

1. Regjistri Themeltar i Urdhrit të Mjekëve është dokumenti bazë, i cili pasqyron gjendjen dhe ndryshimet sasiore dhe cilësore të mjekëve që punojnë në strukturat shëndetësore.
2. Regjistri pasqyron ecurinë e formimit dhe edukimit etiko- profesional e shkencor të mjekëve në vite.
3. Regjistri i mjekëve i mirëadministruar dhe i përditësuar rregullisht merr rol të rëndësishëm në rinovimin e Liçensës për Ushtrimin Individual të Profesionit në vartësi të kriterëve të parashikuara në këtë Rregullore.
4. Regjistri Themeltar i Urdhrit të Mjekëve është në formë Elektronike dhe të shkruar, (manual), sipas formateve të miratuara nga kjo rregullore.

5. Në regjistrin themeltar të Urdhrit të Mjekëve duhet të përmbahen këto të dhëna:

**A. TË DHËNA IDENTIFIKUESE:**

1. Emri, Atësia, Mbiemri dhe Mbiemri i mëparshëm
2. Kodi Unik i Mjekut (Nr. Dosjes)
3. Gjinia
4. Data e lindjes
5. Vendi i lindjes
6. Kombësia/Shtetësia
7. Nr. Personal i Letërnjoftimit
8. Vendbanimi (adresa e banimit)
9. Adresa e kontaktit (Cel. Tel. Fax. e-mail)

**B. TË DHËNA PROFESIONALE:**

1. Universiteti/Fakulteti
2. Data e diplomimit
3. Nr. i Diplomës (Njehsimit nga autoritetet kompetente për mjekët me diplomë të huaj)
4. Specializime
5. Universiteti/Fakulteti ku është kryer specializimi
6. Periudha gjatë së cilës është kryer specializimi
7. Nr. i Diplomës së Specializimit (Njehsimit nga autoritetet kompetente për mjekët me diplomë të huaj)
8. Kualifikimet profesionale
9. Grada Shkencore/Tituj Shkencorë/ dhe vlerësime të tjera
10. Vendi ku ushtron Profesionin mjeku (Q.Sh.; Spitali publik/privat; etj.)

**C. TË DHËNA ANËTARËSIE:**

1. Data e anëtarësimit pranë Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë
2. Këshilli Rajonal
3. Data e pagesës së kuotave të anëtarësisë
4. Data e lëshimit të liçensës së parë
5. Data e lëshimit të liçensës aktualisht të vlefshme
6. Masa Disiplinore të dhëna ndaj mjekut
7. Data e rënies/shfuqizimit të masës disiplinore
8. Çregjistrimi nga Urdhri i Mjekëve të Shqipërisë (Shkaqet/arsyet dhe vendimi)
9. Riregjistrim
10. Shënime të tjera plotësuese.

## **Neni 5. Regjistri Provizor**

1. Regjistri provizor shërben për regjistrimin e të gjithë mjekëve të sapodiplomuar, që i nënshtrohen praktikës profesionale dhe pas përfundimit të saj provimit të shtetit.
2. Regjistri provizor mbahet në formë elektronike dhe të shkruar (manual).
3. Për çdo mjek që i nënshtrohet regjistrimit provizor hapet dosja individuale ku administrohen dokumentat si vijon:

- \* Kërkesë me shkrim për anëtarësim ku të pohojë se njih Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore, Betimin e Mjekut dhe Statutin e Urdhrit dhe se do t'i respektojë e t'i zbatojë ato me përpikmëri;
- \* Vetdeklarimi sipas formatit të përcaktuar nga Urdhri i Mjekëve;
- \* Fotokopje e pashaportës ose e Letërnjoftimit;
- \* Dokumenti zyrtar që vërteton studimet universitare, listë notash;
- \* Për ata që kanë kryer studimet jashtë shtetit, dokumentin zyrtar të njehsuar nga Ministria e Arsimit;
- \* 3 (tre) copë fotografi 3x4 cm;
- \* Tarifën e regjistrimit;

Dokumentat e mësipërme paraqiten të njehsuara me origjinalin dhe mbeten pjesë e dosjes së praktikantit, që ruhet pranë Urdhrit të Mjekëve.

4. Regjistri provizor mbahet nga Sektori i Regjistrim/Çertifikimit, pranë të cilit mjekët e sapodiplomuar paraqiten dhe plotësojnë dosjen e tyre.

## **Neni 6. Regjistrat Rajonale të Urdhrit të Mjekëve**

1. Regjistrat Rajonale krijohen pranë çdo Këshilli Rajonal dhe shërben për të pasqyruar dhe mbikqyrur jo vetëm gjendjen numerike dhe lëvizjen mekanike të mjekëve të rajonit, por edhe përditësimin me ndryshimet cilësore në edukimin etik, formimin profesional, kompetencën, performancën, sjelljen profesionale, vjeljen e kuotave të anëtarësisë, masa disiplinore, etj.
2. Regjistri është në format elektronik dhe të shkruar (sipas modelit të miratuar nga kjo rregullore).
3. Regjistrimet e reja, si dhe të dhënat e tjera që rezultojnë në procesin e përditësimit të Regjistrit, i raportohen Sektorit të regjistrim/Çertifikimit pranë Këshillit Kombëtar për t'u pasqyruar në Regjistrin Themeltar Kombëtar të Urdhrit.

## **Neni 7. Strukturat e ngarkuara për regjistrimin e anëtarësisë**

1. Pranë Këshillit Kombëtar funksionon Sektori i Regjistrim/Çertifikimit dhe Komisioni i Liçensimit.
2. *Sektori i Regjistrimit, Liçensimit dhe Praktikës Profesionale* kryen këto funksione dhe detyra:
  - a. Krijon Regjistrin Kombëtar në të cilin regjistrohen të gjithë mjekët anëtarë të Urdhrit në rang vendi.
  - b. Përditëson këtë regjistër duke shtuar anëtarësimet e reja, të cilat i raportohen periodikisht nga Këshillat Rajonale, si edhe ato që kryhen nga vet sektori.

- c. Shton dhe pasqyron në kurrikulën profesionale të çdo mjeku të dhënat e reja që rezultojnë dhe raportohen nga përditësimi i regjistrave rajonale, burime të tjera zyrtare, si dhe nga vet sektori.
- d. Kujdeset për mirëadministrimin e regjistrit në faqen zyrtare të internetit dhe pasqyrimin në të me korrektësi të të dhënave dhe ndryshimeve të reja për çdo mjek.
- e. Krijon regjistrin provizor për mjekët e sapodiplomuar për praktikën profesionale dhe provimin e shtetit.
- f. Hap dosjet individuale për mjekët e huaj që kërkojnë të ushtrojnë profesionin në Republikën e Shqipërisë, si dhe për mjekët shtetas shqiptar që kanë kryer studimet dhe specializimet jashtë shtetit dhe anëtarësohen për herë të parë në Urdhrin e Mjekëve dhe i regjistron ata në Regjistrin Kombëtar.
- g. Mbikqyr dhe kujdeset për mirëadministrimin e regjistrave pranë këshillave rajonale.

3. *Komisioni i Liçensimit* krijohet me Urdhër të Presidentit të Këshillit Kombëtar. Përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, dy mjekë/ një jurist dhe kryen këto funksione dhe detyra:

- a. Verifikon dokumentacionin e dosjeve të mjekëve që i paraqiten nga Sektori i Regjistrimit, Liçensimit dhe Praktikës Profesionale dhe kur rezulton që ato janë në përputhje me kërkesat dhe kriteret e parashikuara në këtë rregullore, firmos liçencat e mjekëve. Liçensat firmosen detyrimisht nga të gjithë anëtarët e komisionit.
- b. Shqyrton dhe ju jep përgjigje ankesave, të cilat i paraqiten nga Sektori i Regjistrimit, Liçensimit dhe Praktikës Profesionale lidhur me paqartësitë dhe kundërshtitë e mbërritura për probleme që kanë të bëjnë me anëtarësimet, pajisjen me liçensë etj. Shqyrtimi i ankesave bëhet me praninë e të gjithëve anëtarëve të Komisionit.
- c. Në rast refuzimi të anëtarësimin apo të pajisjes me liçensë, komisioni del me vendim të veçantë me shkrim duke argumentuar arsyet e këtij refuzimi.

4. Regjistrimet e anëtarësisë në Urdhrin e Mjekëve të Shqipërisë, të cilat nuk janë të përmendura në paragrafet e mësipërme të kësaj dispozite realizohen pranë Këshillave Rajonale të Urdhrit të Mjekëve.

### **Neni 8. Kriteret dhe dokumentacioni që nevojitet për anëtarësim**

1. Anëtarë të Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë janë shtetasit shqiptarë dhe të huaj, të cilët janë diplomuar me titullin mjek dhe rezultojnë në Regjistrin Themeltar të Urdhrit të Mjekëve.

2. Për t'u regjistruar anëtar në Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë duhen paraqitur dokumentet e mëposhtme:

#### **Për shtetasit shqiptar**

1. Pashaporta ose Letërnjoftimi i vlefshëm;

2. Kërkesën për anëtarësim, në të cilën shprehet se njih Statutin e UMSH, Betimin e Mjekut dhe Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore dhe zotohet se do t'i respektojë ato me përpikmëri;
3. Curriculum Vitae profesionale;
4. Dokumentin zyrtar, i cili vërteton studimet, kualifikimet, specializimet e kryera dhe titujt e fituar;
5. Nëse ka ushtruar më parë profesionin, referencë të protokolluar nga organi drejtues i institucionit shëndetësor apo social-shëndetësor ku ka shërbyer;
6. Dëshmi penaliteti nga organi përkatës, ose vërtetim nga gjykata dhe prokurori, ku vërtetohet se nuk ka vuajtje dënimi;
7. 3 (tre) cope fotografi 3 x 4 cm;
8. Për mjekët e rinj, dokumentin zyrtar, i cili vërteton se ka kryer praktikën profesionale dhe ka kaluar provimin e shtetit.

### **Për shtetasit e huaj**

1. Leja e qëndrimit në Republikën e Shqipërisë.
  2. Pashaportë ose letërnjoftim
  3. Çertifikatë e mirësjelljes (Good Standing Certificate) nga Urdhri/Dhoma apo Shoqata e Mjekëve të vendit të vet, ku vërtetohet se është i regjistruar e ushtron profesionin dhe se nuk është i ndëshkuar dhe me vuajtje dënimi;
  4. Njehsimi i diplomës dhe çertifikatave të specializimeve të kryera prej tij/saj të lëshuara nga autoriteti shqiptar kompetent, si dhe kopje të diplomës dhe të specialitetit të njehsuar.
  5. Rekomandim nga një specialist vendas i të njëjtës fushë, anëtar i Urdhrit të Mjekëve.
  6. Mjeku i huaj rezident në Shqipëri të njohë Gjuhën Shqipe, dhe të ketë aftësi komunikimi në Shqip. Për mjekun jo rezident detyrimisht të punoj me përkthyes.
3. Në lidhje me dokumentacionin e sjellë nga shtetasit e huaj ato duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe konform ligjeve në fuqi.

## **Neni 9. Proçedurat për anëtarësimin**

Proçedurat për regjistrim/liçensimin kryhen nga Sektori i Regjistrimit, Liçensimit dhe Praktikës Profesionale pranë Këshillit Kombëtar të UMSH-së dhe nga Këshillat Rajonale.

### **Proçedurat e regjistrim/liçensimit në Sektorin e Regjistrim/Çertifikimit pranë Këshillit Kombëtar kryhet për dy kategori mjekësh:**

1. Mjekët e sapodiplomuar
  2. Mjekët shtetas të huaj të cilët kërkojnë të ushtrorë profesionin në Republikën e Shqipërisë, si dhe mjekët shtetas shqiptar që janë diplomuar apo specializuar jashtë shtetit dhe regjistrohen për herë të parë si anëtar të Urdhrit.
- 1) Për mjekët e sapodiplomuar, proçedurat kryhen bazuar në Rregulloren "Për Organizimin e Praktikës Profesionale" miratuar me vendim të Këshillit Kombëtar Nr.3 datë 22.04.2011 dhe të Rregullores "Për Praktikën Profesionale për Profesionistin e Shëndetit në Republikën e Shqipërisë" të Ministrisë së Arsimit, si

mbas të cilave, Sektori i Regjistrimit, Liçensimit dhe Praktikës Profesionale krijon regjistrin provizor.

Proçedurat që ndiqen:

- a) Hapet dosja individuale e mjekut e cila plotësohet me të gjithë dokumentat që kërkohen në rregulloret e sipërcituara
  - b) Regjistrohen në regjistrin provizor dhe pajisen me librezën e praktikantit, si dhe me dokumente të tjera shoqëruese për praktikën profesionale.
  - c) Me përfundimin e praktikës profesionale dhe kalimin me sukses të provimit të shtetit, gjithnjë në përputhje me kërkesat e akteve nënligjore bëhet regjistrimi definitiv në Regjistrin Kombëtar si anëtar i UMSH-së, dhe pajiset me liçensën.
- 2) Për mjekët shtetas të huaj, si edhe ata shtetas shqiptar që janë diplomuar apo specializuar jashtë shtetit, të cilët regjistrohen për herë të parë si anëtar i Urdhrit, ndiqen këto proçedura:
- a) Hapet dosja individuale e mjekut e cila plotësohet me të gjithë dokumentet, që parashikon kjo rregullore.
  - b) Bëhet regjistrimi i mjekut në Regjistrin Kombëtar si anëtar i UMSH-së.
  - c) Në të dy rastet, si për ata që shtjellohen në pikën 1, po ashtu edhe ata që shtjellohen në pikën 2 të këtij rregulli, dosja e kompletuar me dokumentacionin e detyrueshëm, si dhe liçensa për ushtrimin individual të profesionit, e parapërgatitur nga Sektori i Regjistrimit, Liçensimit dhe Praktikës Profesionale, i paraqiten komisionit të liçensimit për shqyrtim dhe firmosje;
  - d) Kur anëtarët e komisionit të liçensimit janë bindur për rregullsinë e dokumentacionit, bëjnë firmosjen e liçensës me të cilën Sektori i Regjistrimit, Liçensimit dhe Praktikës Profesionale e pajis mjekun aplikant.

### **Procedurat e regjistrimit/liçensimit në Këshillin Rajonal**

Proçedurat e regjistrimit/liçensimit në Këshillin Rajonal kryhen në përputhje me të gjithë normat dhe kërkesat e shtjelluara në këtë rregullore.

1. Në Këshillin Rajonal regjistrohen, anëtarësohen, liçensohen dhe riliçensohen mjekët sipas këtyre kriterëve e kategorive:
  - a. Të gjithë mjekët që tashmë ushtrojnë profesionin në juridiksion të këtij këshilli.
  - b. Mjekët shtetas shqiptar që kanë kryer kualifikime, specializime brenda apo jashtë shtetit, të cilët kanë qenë të regjistruar si anëtar të Urdhrit parapakisht dhe ushtrojnë profesionin në juridiksion të atij Këshilli.
2. Dosjet individuale të Mjekëve të sapodiplomuar që kanë marrë Provimin e Shtetit, mjekëve shqiptarë që kanë kryer studimet/specializimet jashtë shtetit, si dhe mjekëve shtetas të huaj të regjistruar dhe liçensuar për herë të parë nga Këshilli Kombëtar dërgohen për t'u regjistruar në Këshillin Rajonal ku do të ushtrojnë profesionin.

3. Në çdo rast dosjet e plotësuara në Këshillin Rajonal nga sekretari i këtij Këshilli, si dhe dosjet e ardhura në administrimin e tij si në rastin e pikës 1 të shkronjës “b” të këtij neni, i paraqiten për verifikim Presidentit të Këshillit Rajonal, i cili urdhëron regjistrimin e mjekut dhe e pajis atë me liçensën për ushtrimin individual të profesionit kur nuk e zotëron këtë. Liçensa detyrimisht firmoset nga Presidenti dhe sekretari i Këshillit dhe i vihet vula e Këshillit Rajonal.
4. Në rast se mjeku që ka paraqitur kërkesën për regjistrim si anëtar në Këshillin Rajonal të UMSH-së dhe ka një periudhë mbi 5 (pesë) vite që nuk ushtron profesionin si mjek, i nënshtrohet rikualifikimit të aftësive të tij profesionale, duke punuar vullnetarisht pranë një institucioni shëndetësor shtetëror për një periudhë 6 (gjashtë) muajore. Presidenti i Këshillit Rajonal të Urdhrit të Mjekëve i drejtohet institucionit shëndetësor, ku cakton të kryhet rikualifikimi i aftësimin profesional të mjekut.
5. Mjeku pasi mbaron periudhën e rikualifikimit të aftësive profesionale dhe paraqet dokumentacionin përkatës pranë Këshillit Rajonal të Urdhrit të Mjekëve, ky i fundit e pajis atë me liçensën përkatëse.
6. Në rast refuzimi për regjistrimin si anëtar, del me vendim duke shprehur në të arsyet e këtij refuzimi.

## **Neni 10. Llojet e dokumentave që lëshohen nga Urdhri i Mjekëve**

Urdhri i Mjekëve të Shqipërisë lëshon këto dokumenta:

**ÇERTIFIKATË PROVIZORE E PRAKTIKANTIT**- për ushtrim të profesionit nën mbikqyrje. Me këtë dokument pajisen mjekët e sapodiplomuar, pasi të kenë bërë regjistrimin provizor pranë Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë dhe është i vlefshëm vetëm për periudhën e kryerjes së praktikës profesionale. Kjo çertifikatë lëshohet nga Sektori i Regjistrimit, Liçensimit dhe Praktikës Profesionale

**LIÇENSA PËR USHTRIMIN INDIVIDUAL TË PROFESIONIT PËR MJEK** - është liçensa për ushtrim të pavarur dhe i lëshohet mjekut/mjekut specialist, i cili është i regjistruar si anëtar në Regjistrin Themeltar të Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë. Kjo liçensë është e vlefshme për 5 (pesë) vjet dhe me skadimin e afatit ripërtërihet në bazë të kriterëve dhe të dokumentacionit të përcaktuara në këtë rregullore.

**ÇERTIFIKATA E SJELLJES SË MIRË (Good Standing Certificate)** – mekanizmi më i zakonshëm për shkëmbim informacionesh për mjekët midis Autoriteteve Mjekësore Rregullatore është lëshimi dhe pranimi i çertifikatës apo dokumentit tjetër ekuivalent. Çertifikata e Sjelljes së Mirë profesionale përfshin:

*Vlera e Çertifikatës:*

- Emri I plotë i Urdhrit të Mjekëve (adresa e plotë, numri i telefonit, e maili dhe firma e titullarit);
- Data e lëshimit;
- Numri i regjistrimit të Çertifikatës;
- Data e skandimit të Çertifikatës;
- Logo dhe vula e institucionit;

*Indentiteti i Mjekut:*

- Emri i plotë;
- Atësia;
- Datëlindja;
- Numri i regjistrimit të Urdhrit të Mjekëve;
- Numri unik i mjekut;

*Kualifikimet mjekësore primare:*

- Emërtimi i kualifikimit, përshkrimi, emri i organit që ka dhënë diplomën, numrin e diplomës dhe datën e diplomimit.

*Specializimi*

- Emërtimi i kualifikimit dhe përshkrimi i specializimit.

*Gjendja e regjistrimit:*

- Data e regjistrimit të plotë të mjekut;
- Të dhëna mbi kufizimet, kushtet apo ndalesat (vullnetare apo të detyrueshme);
- Të dhëna mbi ndalimin e ushtrimit të profesionit;
- Nëse ka masa disiplinore kundrejt mjekut;

VËRTETIME të ndryshme që lëshohen nga Këshillat Rajonale dhe Këshilli Kombëtar i UMSH-së.

## **Neni 11. Rinovimi i liçensës**

1. Liçensa rinovohet pranë Këshillave Rajonale, ku mjeku është i regjistruar dhe ushtron aktivitetin e tij. Rinovimi i liçensës për ushtrimin individual të profesionit bëhet brenda 30 ditëve nga plotësimi i dokumentave.

2. Pajisja me liçensë për ushtrimin individual të profesionit kryhet bazuar në të dhënat e mbledhura dhe të verifikuara nga vlerësimi dhe rivlerësimi periodik i kompetencës, performancës dhe sjelljes profesionale të mjekut. Për këtë qëllim, për t'u pajisur me

liçensën për ushtrimin individual të profesionit aplikanti duhet të paraqesë në Urdhrit të Mjekëve këto dokumenta:

- a. Vetëdeklarim sipas formularit standard të lëshuar nga Urdhri i Mjekëve;
- b. Riçertifikimin nga QKEV-ja. Çdo mjek nga Janari 2020 duhet të ketë 150 kredite për të rinovuar liçensën individuale të ushtrimit të profesionit nga UMSH-ja;
- c. Referencë vlerësuese zyrtare, e lëshuar nga Drejtoria e institucionit shëndetësor ku punon, mbi kompetencën, performancën, sjelljen profesionale, opinonin e publikut dhe të të sëmurëve sipas formularit standard të lëshuar nga UMSH-ja.

3. Në rast të mos plotësimit të kriterëve për rinovimin e liçensës, Këshilli Rajonal i Urdhrit të Mjekëve refuzon rinovimin e liçensës së mjekut.

4. Mjekut, të cilit i është refuzuar rinovimi i liçensës ka të drejtë të paraqesë ankesën e tij tek Sektori i Regjistrimit, Liçensimit dhe Praktikës Profesionale pranë Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë.

5. Pas marrjes së ankesës së mjekut, të cilit i është refuzuar riliçensimi dhe pas tërheqjes së dosjes nga Këshilli Rajonal përkatës, rasti i kalon për trajtim Komisionit të Liçensimit, i cili vendos në lidhje me këtë çështje. Vendimi i marrë nga Komisioni i Liçensimit është i detyrueshëm për çdo Këshill Rajonal.

## **Neni 12. Pezullimi i liçensës**

Kriteret për pezullimin apo heqjen e përkohëshme të liçensës janë të përcaktuara në Statutin e Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë.

## **Neni 13. Çregjistrimin nga anëtarësia**

1. Çregjistrimi nga anëtarësia e Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë bëhet në rastet kur:

- a. Mjeku paraqet një kërkesë me shkrim për çregjistrim të anëtarësisë nga Urdhri, ku paraqet shkaqet përse kërkon të çregjistrohet.
- b. Mjeku është dënuar me vendim të formës së prerë nga organet e drejtësisë lidhur me vepra penale, që kanë të bëjnë me ushtrimin e profesionit të mjekut.
- c. Në rastet e tjera të parashikuara nga ligjet në fuqi.

2. Në regjistrin themeltar të Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë bëhet shënimi lidhur me çregjistrimin e mjekut dhe arsyet e këtij çregjistrimi. Në asnjë rast mjeku nuk fshihet nga regjistri themeltar.

3. Për mjekët që janë çregjistruar si anëtarë të Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë konform gërmës a të paragrafit të parë, kanë të drejtë të paraqesin kërkesë për reregjistrim, pasi të plotësojnë edhe një herë të gjitha procedurat për regjistrimin fillestar.

## **Neni 14. Ankimi**

1. Ndaj çdo vendimi të dhënë nga Këshilli Rajonal ndaj mjekut lidhur me mosregjistrimin apo mosrinovimin e liçensës, mjekut i lind e drejta që brenda 15 ditësh të paraqesë ankesë në Sektorin e Regjistrimit, Liçensimit dhe Praktikës Profesionale pranë Këshillit Kombëtar.

2. Ndaj çdo vendimi të dhënë nga Komisioni i Liçensimit lidhur me mosregjistrimin e mjekëve, si dhe lidhur me vendimet e ankimuarra pranë Sektorit të Regjistrimit, Liçensimit dhe Praktikës Profesionale ndaj vendimeve të Këshillit Rajonal, mjekut i lind e drejta të paraqesë ankesë, konform Kodit të Proçedurave Administrative, duke ju drejtuar organit gjyqësor kompetent.

3. Vendimet e formës së prerë lidhur me ankimimin e bërë nga mjeku, referuar paragrafeve të mësipërme janë të detyrueshme për Këshillin Rajonal.

### **Neni 15. Mbrojtja e të dhënave personale të mjekut**

Në mbështetje të Ligjit të Mbrojtjes së të Dhënave Personale, Urdhri i Mjekëve ruan të gjitha të dhënat personale të anëtarësisë së vet. Regjistri Kombëtar i UMSH-së dhe dosja personale e mjekut janë pjesë e privatësisë të Urdhrit të Mjekëve. Nxjerrja e të dhënave personale apo përpunimi i tyre në shkelje të ligjit për mbrotjen e të dhënave personale përbën kundravajtje administrative.

### **Neni 16. Dispozita të fundit**

1. Kjo rregullore shfuqizon rregulloren e mëparshme dhe hyn në fuqi menjëherë.

2. Çdo Këshill Rajonal ka përgjegjësinë për t'i njohur anëtarët e tij me përmbajtjen e kësaj rregulloreje.

3. Kësaj rregulloreje i bashkangjiten edhe formularët dhe modelet lidhur me dokumentacionin e përmendur në të.

*Miratuar më Vendimin Nr 7, datë 08.07.2016 të Këshillit Kombëtar, i ndryshuar me Vendimin Nr. 4, datë 07.07.2017 të Këshillit Kombëtar, ndryshuar me Vendimin nr. 8, datë 21.12.2018 të Këshillit Kombëtar, ndryshuar me Vendimin Nr. 4, datë 08.11.2019.*

**P R E S I D E N T I**

**DR. FATMIR BRAHIMAJ**